



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2633/Prot.
7

Tiranë, më 22 / 10/2024

V E N D I M

Nr. 16, datë 22.10.2024

PËR

**MIRATIMIN E AKTIVIZIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME NUMËR
STUDENTËSH MË PAK SE DHJETË NË FAKULTETIN E INXHINIERISË
MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE DHE NË FAKULTETIN E
GJEOLGJISË DHE TË MINIERAVE, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË
TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, në Vendimin Nr. 33, datë 21.10.2024 të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, në Vendimin Nr. 09, datë 16.10.2024 të Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e aktivizimit të programit të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional në Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh” në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, me numër studentësh më pak se 10 dhjetë, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2024-2025;
2. Miratimin e aktivizimit të programeve të studimit të ciklit të parë “Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike” dhe “Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare”, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, me numër studentësh më pak se dhjetë, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2024-2025.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë,

KRYETARI

Prof. Dr. Akil Fundo